



Informata lidhur me përkushtimin e Bashkimit Evropian ndaj veriut të Kosovës

Hyrje

Të gjitha 27 shtetet anëtare të BE-së janë të përkushtuara ndaj perspektivës evropiane të Ballkanit Perëndimor përfshirë Serbinë dhe Kosovën. Natyrisht kjo e përfshin veriun e Kosovës. Objektivat e BE-së për veriun e Kosovës janë të njëjta si edhe për tërë Kosovën: përkrahja e qeverisjes së mirë, zhvillimi shoqëroro-ekonomik dhe forcimi i sundimit të ligjit. Këto objektiva janë duke u zbatuar nga organizatat e BE-së në veri, nga Zyra Ndërlidhëse e Komisionit Evropian dhe Misioni Evropian për Sundimin e Ligjit (EULEX). Puna e tyre bashkërendohet së bashku me fasilituesin e BE-së për veri, njëkohësisht ambasadorin italian, Michael Giffoni.

Çka është duke bërë BE-ja në praktikë në veri?

- Zyra Ndërlidhëse e KE-së, mes tjerash, ju ka ndihmuar shumë bizneseve të vogla t'i fillojnë dhe t'i zgjerojnë aktivitetet e tyre, për shembull ndërmarrjes për përpunimin e drurit "Javor" nga Brnjaku, furrës së bukës "Kolashin" në Zubin Potok, "Tara-Komerc" në Leposaviq dhe "Extra Plast" dhe "Dynamic Trade" në Zveçan.
- Janë krijuar rreth 230 vende të qëndrueshme të punës dhe është bërë një investim prej gjithsej më shumë se 4.6 milionë euro.
- 1.1 milion euro janë investuar në rafinerinë e plumbit në Zveçan ku janë duke u ricikluar me qindra tonë të baterive të shfrytëzuara të veturave.
- Zyra Ndërlidhëse e KE-së është e përfshirë në disa projekte të cilat janë duke u zbatuar, për shembull vendosja kiosqeve në tregun e Mitrovicës veriore, ndërtimi i tregut ndërkombëtar me shumicë, kompleksi afarist në Zveçan dhe zhvillimi i bregut të lumit Ibër. Po ashtu është duke e ndërtuar një qendër shëndetësore në Zubin Potok, një fabrikë e ujit për zonën e Mitrovicës dhe një sistem për pastrimin e ujit në Leposaviq.
- EULEX-i, i mbështetur nga të gjitha shtetet anëtare të BE-së, beson që duhet të forcohet sundimi i ligjit në mënyrë që të përfitojnë të gjitha komunitetet në Kosovë, përfshirë veriun.
- EULEX-i e ka rihapur gjykatën në Mitrovicë dhe tashmë janë mbajtur 11 gjykime. EULEX-i është duke u përpjekur shumë që t'i kthejë gjykatësit dhe prokurorët vendas përsëri në punë.
- EULEX-i ka prani 24 orëshe të policisë dhe të doganës në portën 1 dhe 31 në mënyrë që ta luftojë krimin e organizuar, përfshirë kontrabandën. Vlerësohet që prej fillimit të pranisë së EULEX-it në portën 1 dhe 31 kontrabanda është zvogëluar për 60%.
- EULEX-i ka 13 zyrtarë të përhershëm të policisë në 4 stacionet veriore të cilët e bëjnë monitorimin dhe ka zyrtarë shtesë në porta.
- Puna e Zyrës Ndërlidhëse të KE-së dhe e EULEX-it e sjellë rajonin më afër rrugës për arritjen e perspektivës evropiane.



EULEX-i ndërton sundimin e ligjit



Zyra ndërlidhëse e Komisionit Evropian mbështetëse të bizneset e vogla

**Personi kontaktues
për shtyp në Shtëpinë e BE-së:**

Hanns-Christian Klasing

Zyra: +386 (0)43 78 7107

GSM: +386 (0)49 78 2017, +381 (0)64 500 57 65